

RELACION

Rikonstruksionin i Shkollës së Mesme “Elez Isuf Ndreu”, Bashkia Kamëz.

1. Hyrje

Ky relacion hartohet në kuadër të përcaktimit të Termave të Referencës për projektimin dhe realizimin e rikonstruksionit të plotë të Shkollës së Mesme “Elez Isuf Ndreu”, në Bashkinë Kamëz. Objekti ka funksion publik arsimor dhe shërben për zhvillimin e procesit mësimor për rreth 600 nxënës.

Ndërhyrja synon përmirësimin e kushteve fizike, funksionale, teknike dhe energjetike të godinës, duke e përshtatur atë me standardet bashkëkohore të objekteve arsimore, normat e sigurisë, aksesueshmërisë dhe eficiencës së energjisë.

Vendndodhja e objektit

Shkolla e Mesme “Elez Isuf Ndreu” ndodhet në Rrugën “Lazan Troci”, në territorin administrativ të Bashkisë Kamëz. Objekti është i pozicionuar në një zonë urbane të banuar, me akses nga rruga kryesore dhe me lidhje të përshtatshme me infrastrukturën rrugore të zonës.

Vendndodhja e shkollës mundëson shërbimin ndaj komunitetit përreth dhe garanton akses të lehtë për nxënësit, stafin pedagogjik dhe përdoruesit e tjerë të objektit. Në kuadër të rikonstruksionit, rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet organizimit të hyrje-daljeve, sigurisë së lëvizjes së nxënësve dhe sistemit të hapësirave të jashtme përreth objektit



Gjendja ekzistuese dhe nevoja për ndërhyrje

Objekti ekzistues i Shkollës së Mesme “Elez Isuf Ndreu” ka nevojë për rikonstruksion të plotë me qëllim përmirësimin e kushteve fizike, funksionale dhe teknike. Ndërhyrja është e domosdoshme për të garantuar ambiente mësimore të sigurt, të shëndetshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit arsimor. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet përmirësimit të instalimeve teknike, rritjes së eficiencës energjetike, aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara dhe forcimit të masave të sigurisë në objekt.



2. Të dhënat kryesore të objektit

1	Emërtimi i objektit	Shkolla e Mesme “Elez Isuf Ndreu”
2	Vendndodhja	Bashkia Kamëz
3	Tipologjia	Objekt publik arsimor
4	Lloji i ndërhyrjes	Rikonstruksion i plotë
5	Sipërfaqe ndërtimi	4,095 m ²
6	Gjurmë ndërtimi	1,365 m ²
7	Numri i kateve	3 kate mbi tokë
8	Kapaciteti	Rreth 600 nxënës
9	Funksioni kryesor	Zhvillimi i procesit mësimor për arsimin e mesëm
10	Përfituesit	Nxënësit, stafi pedagogjik dhe komuniteti lokal

Qëllimi i projektit

Qëllimi kryesor i projektit është rikonstruksioni i plotë i godinës ekzistuese të shkollës, me fokus në:

- Përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Riorganizimin funksional të ambienteve të brendshme;
- Rritjen e sigurisë konstruktive dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Përmirësimin e eficiencës energjetike;
- Sigurimin e aksesit universal për personat me aftësi të kufizuara;
- Modernizimin e sistemeve teknike mep;
- Sistemimin e hapësirave të jashtme dhe territorit përreth.

4. Programi funksional

Organizimi funksional i objektit do të mbështetet në nevojat e një institucioni arsimor të mesëm dhe do të përfshijë ambiente mësimore, administrative, teknike dhe ndihmëse.

Në **katin përdhe** parashikohen hyrja kryesore, recepsioni, klasa mësimore, laboratorë, bibliotekë, sallë mbledhjesh, nyje sanitare dhe ambiente teknike.

Në **katin e parë** do të organizohen klasa, laboratorë, drejtorja, sekretaria, salla e mësuesve, nyje sanitare dhe ambiente teknike.

Në **katin e dytë** do të vendosen klasa, kabinete, nyje sanitare, depo dhe ambiente të tjera teknike, sipas kërkesave funksionale të shkollës.

ORGANIZIMI FUNKSIONAL I OBJEKTIT

KATI PËRDHE

Hyrje kryesore → Recepsion → Klasa / Laboratorë → Bibliotekë → Sallë mbledhjesh → Nyje sanitare → Ambiente teknike

KATI I

Klasa / Laboratorë → Drejtori → Sekretari → Sallë mësuesish → Nyje sanitare → Ambiente teknike

KATI II

Klasa → Kabinete → Nyje sanitare → Depo → Ambiente teknike

5. Kërkesat arkitektonike

Projektimi arkitektonik duhet të sigurojë një objekt funksional, të sigurt, të qëndrueshëm dhe të

përshtatshëm për përdorim arsimor. Duhet të garantohet akses universal për PAK, përmes rampave, ashensorit dhe zgjidhjeve të tjera të nevojshme sipas standardeve në fuqi.

Organizimi i brendshëm duhet të sigurojë ndarje të qartë të flukseve të nxënësve, stafit dhe vizitorëve, orientim të lehtë në objekt përmes sistemit të sinjalistikës dhe wayfinding, si dhe fleksibilitet për përdorim të ambienteve sipas nevojave të ndryshme mësimore.

Materialet që do të përdoren duhet të jenë rezistente, të lehta për mirëmbajtje dhe të përshtatshme për ambiente arsimore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndriçimit dhe ventilimit natyral, komoditetit termik dhe akustik, si dhe krijimit të një mjedisi të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin.

6. Kërkesat konstruktive

Ndërhyrjet konstruktive duhet të bazohen në vlerësimin teknik të gjendjes ekzistuese të objektit dhe në përputhje me standardet europiane të projektimit, përfshirë Eurocode gjithashtu dhe SSH. Struktura duhet të trajtohet si strukturë betonarme antisizmike, me kategori rëndësie III dhe jetëgjatësi minimale projektimi 50 vjet.

Projekti konstruktiv duhet të përfshijë analizën sizmike të objektit, verifikimin e elementeve mbajtëse, ndërhyrjet për përforcim aty ku është e nevojshme, si dhe vlerësimin e rezistencës ndaj zjarrit të strukturës.

7. Kërkesat MEP

Projektet MEP duhet të sigurojnë funksionim bashkëkohor, efikas dhe të sigurt të objektit.

Instalimet elektrike duhet të përfshijnë furnizimin kryesor dhe rezervë me energji, UPS për sistemet kritike, gjenerator, ndriçim LED, tokëzim, rufepritës dhe panele shpërndarëse sipas normave teknike.

Instalimet hidrosanitare duhet të parashikojnë furnizim të qëndrueshëm me ujë, rrjet kanalizimesh, rezervuar uji sanitar dhe rezervuar të veçantë për sistemin zjarrfikës.

Sistemi HVAC duhet të projektohet me pajisje me eficiencë të lartë energjetike, duke përfshirë ngrohjen, ftohjen dhe ventilimin mekanik të ambienteve sipas kërkesave të përdorimit.

8. Mbrojtja nga zjarri dhe sistemet speciale

Objekti duhet të pajiset me sistem alarmi zjarri, hidrantë të brendshëm dhe/ose të jashtëm sipas projektit MBZ, ndriçim emergjence, sinjalistikë evakuimi dhe rrugë të sigurta daljeje.

Gjithashtu, duhet të parashikohen sisteme speciale si CCTV, kontroll aksesi, rrjet IT, Wi-Fi dhe infrastrukturë komunikimi për funksionimin normal të institucionit arsimor.

9. Panelet fotovoltaike dhe eficienca energjetike

Në kuadër të rritjes së eficiencës energjetike, projekti duhet të parashikojë vendosjen e një impianti fotovoltaik me kapacitet rreth **80–100 kWp**. Duhet të hartohet studim i veçantë i eficiencës energjetike, duke analizuar konsumin aktual, masat për reduktimin e energjisë dhe ndikimin e sistemit fotovoltaik në mbulimin e nevojave të objektit.

10. Sistemimi i territorit të jashtëm

Hapësirat e jashtme duhet të trajtohen në mënyrë funksionale dhe estetike. Projekti duhet të përfshijë rrugët e aksesit, hapësirat e parkimit, gjelbërimin, ndriçimin e jashtëm, gardhin rrethues, sinjalistikën dhe elementët e sigurisë për lëvizjen e nxënësve dhe stafit.

11. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

Në përfundim të fazës së projektimit, duhet të dorëzohet dokumentacioni i plotë teknik, ku përfshihen:

- Projekti arkitektonik;
- Projekti konstruktiv;
- Projekti elektrik;
- Projekti hidrosanitar;
- Projekti hvac;
- Projekti i mbrojtjes nga zjarri;
- Projekti i impiantit fotovoltaik;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i realizimit të punimeve;
- Relacionet teknike;
- Specifikimet teknike për çdo disiplinë.

12. Staf i minimal i kërkuar

Për hartimin e projektit dhe ndjekjen teknike të tij kërkohet angazhimi i një ekipi multidisiplinar, i përbërë minimalisht nga:

- Arkitekt, drejtues projekti;
- Inxhinier konstruktor;
- Inxhinier elektrik dhe elektroteknik;
- Inxhinier mekanik;
- Inxhinier hidroteknik;
- Inxhinier mjedisi;
- Ekspert i mbrojtjes nga zjarri;
- Ekspert i eficiencës së energjisë;
- Gjeolog;
- Gjeodet;
- Sizmolog;

- Specialist IT;
- Preventivues.

13. Përfundime

Rikonstrukcioni i Shkollës së Mesme “Elez Isuf Ndreu” përbën një ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Kamëz. Projekti duhet të realizohet në përputhje me standardet teknike, funksionale, arkitektonike dhe ligjore në fuqi, duke garantuar siguri, komoditet, aksesueshmëri dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Hartoi: Ark.Estela Gjyriqi